

URDHËR
Nr.310, datë 4.7.2011

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT “MASTER PROFESIONAL” NË
“EDUKIM” E “FINANCË-KONTABILITET” DHE FILLIMIN E VEPRIMTARISË AKADEMIKE
PËR KËTO PROGRAME, PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE
“UNIVERSITETI “KRISTAL””, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.761, datë 6.12.2005 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike “Universiteti “Kristal””,

URDHËROJ:

1. Hapjen pranë Fakultetit të Administrimit të Biznesit të shkollës së lartë universitare jopublike, “Universiteti “Kristal””, Tiranë, dhe fillimin e veprimtarisë akademike për programin e ri të studimit të ciklit të dytë, që realizohet me 90 kredite, me kohëzgjatje normale 1.5 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master Profesional” në “Financë-kontabilitet”.

2. Ky program studimi hapet në bazë të vendimit nr.154, datë 18.2.2011 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Hapjen pranë Fakultetit të Shkencave Politike të shkollës së lartë universitare jopublike “Universiteti “Kristal””, Tiranë, dhe fillimin e veprimtarisë akademike për programin e ri të studimit të ciklit të dytë, që realizohet me 90 kredite, me kohëzgjatje normale 1.5 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master Profesional” në “Edukim”.

4. Ky program studimi hapet në bazë të vendimit nr.171, datë 15.4.2011 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.

5. Shkolla e lartë universitare jopublike “Universiteti “Kristal””, Tiranë, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij urdhri.

7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë universitare jopublike “Universiteti “Kristal””, Tiranë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj